# DËSHMI ARKIVI

**A-458771**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | ‘Supreme apo Ekstreme’, Trump propozon ndryshimin e emrit të Inteligjencës Artificiale! Së shpejti 'AI Force' |
| ADRESA | `https://piranjat.al/bota/supreme-apo-ekstreme-trump-propozon-ndryshimin-e-emrit-te-inteligjences-art-i105051` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 20:39:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 20:27:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e5391e6655ef93406be7a978a95b9b7d8e2837bc090db2ba629096c250d48c9f` |
| TEKSTI | `21036a603f5bf0f4792b8d82d0266f943dba12c3c070376a108c60536cfcc9c9` |
| PAMJA | `b62e5a6712ce59060720e1132ca7c9114ae932b1273e89b33d28a0f60fff016f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `99e1c7f06562bae4c0072f675710e012674e8e333b150ed7b14622877de79926` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `552a34f0419bb0f85ba237bcc1ccacbd9efdbebeb1d3d406ed195c7fa79d55c7` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/99e1c7f06562bae4c0072f675710e012674e8e333b150ed7b14622877de79926`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA

# 'Supreme apo Ekstreme', Trump propozon ndryshimin e emrit të Inteligjencës Artificiale! Së shpejti 'AI Force'

Piranjat Përditësimi i fundit 19 Shtator 2026, 22:27



Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, njoftoi të shtunën se do të emërojë një koordinator të posaçëm për inteligjencën artificiale (AI), dhe se do të krijojë gjithashtu një 'grup të posaçëm pune për këtë teknologji.

Nisma vjen pasi studiues të inteligjencës artificiale kanë paralajmëruar se zhvillimi i saj mund të dalë së shpejti jashtë kontrollit njerëzor, duke nxitur shqetësime dhe thirrje për rregullimin e industrisë.

Në një postim në rrjetet sociale, Trump tha se nuk do të lejojë "shkatërrimin" e inteligjencës artificiale.

"Nuk do ta pengojmë apo frenojmë në asnjë mënyrë rritjen e kësaj industrie të jashtëzakonshme. Përkundrazi, do ta mbështesim, do ta ndihmojmë dhe do ta mbikëqyrim teksa zhvillohet! Megjithatë, do të jemi gjithashtu në kërkim të abuzimeve dhe kjo mund të bëhet lehtësisht përmes sistemit tonë ekzistues të drejtësisë penale dhe civile. Për këtë qëllim po krijoj AI Force, ashtu siç krijova Space Force", shkroi Trump në Truth Social.

Trump shtoi se për postin e koordinatorit (anglisht czar role) të AI-së duhet të aplikojnë "vetëm individë me inteligjencë shumë të lartë", por nuk bëri të ditur se kush do ta mbajë këtë detyrë.

Gjatë dy javëve të fundit, Trump i ka quajtur një "mashtrim" paralajmërimet për rreziqet e inteligjencës artificial duke deklaruar se prioriteti duhet të jetë që SHBA-ja të udhëheqë botën në zhvillimin e AI-së dhe të mposhtë Kinën në këtë garë.

"Kush fiton garën AI-në, fiton gjithçka", ka deklaruar Trump disa herë gjatë javës së fundit.

Përmes një serie postimesh në rrjetet sociale, presidenti amerikan mbrojti fuqishëm teknologjinë e inteligjencës artificiale. Ai madje telefonoi drejtorin ekzekutiv të Nvidia-s, Jensen Huang, ndërsa ky i fundit ishte në skenë gjatë një samiti të industrisë për të diskutuar mbi këtë çështje.

Shtëpia e Bardhë nuk ka dhënë ende detaje të mëtejshme mbi iniciativën e re të Trump.

Ndërkohë, përpjekjet e ligjvënësve amerikanë për të miratuar legjislacion mbi inteligjencën artificiale nuk kanë dhënë rezultat në vitet e fundit. Megjithatë, çështja është rikthyer sërish në qendër të debatit pas paralajmërimeve të reja nga ekspertët.

Gjatë një takimi me dyer të mbyllura në Kongres këtë javë, laureati i Nobelit Geoffrey Hinton, i njohur si "babai i inteligjencës artificiale", paralajmëroi ligjvënësit se koha për të rregulluar industrinë po mbaron. Ai tha se Kongresi ka "ndoshta vetëm një vit" për të vepruar, shkruan NBC News.

Në një tjetër postim propozoi edhe ndryshimin e emrit. Trump nisi një sondazh me tre propozime, ku ndjekësit duhet të zgjedhin, duke argumentuar se termi aktual Inteligjencë Artificiale është "i pasaktë" dhe joelegant.

Sipas presidentit të SHBA-së, përkufizime më të përshtatshme mund të jenë

"Inteligjencë Superiore",

"Inteligjencë Ekstreme," ose

“Inteligjencë Supreme “.

“Shumë njerëz mendojnë se fjalët “Inteligjencë Artificiale” janë të pasakta.

"Një përshkrim shumë më elegant dhe i saktë i këtij fenomeni të ri do të ishte Inteligjencë Superiore (SI) ose Inteligjencë Ekstreme (EI) ose Inteligjencë Supreme (SI). Ky është një Sondazh dhe do të vlerësoja të gjithë ata që votojnë!”, shkroi ai.

## Artikuj te sugjeruar

BOTA 19 Shtator18:28

**Takimi i 42-të i FBI-së dhe elitës së sigurisë në Tiranë, nga krimi i organizuar te dronët dhe paratë e krimit**

Tirana është bërë këto ditë qendra e një takimi të rëndësishëm të drejtuesve dhe ekspertëve t&e...

BOTA 19 Shtator16:59

**Panik në aeroportin e Luksemburgut, dronët misteriozë sjellin bllokimin e fluturimeve! Futet në lojë NATO**

Autoritetet e Luksemburgut kanë nisur hetimet pasi disa dronë u panë në hapësirën ajrore pranë aeroportit kryesor të ven...

BOTA 19 Shtator15:04

**Alarmi bëhet serioz! Gemini i Google jashtë kontrollit, hakoi vetë 3 kompani**

Inteligjenca artificiale e Google, Gemini, ka arritur të hakojë në mënyrë autonome tre kompani gjatë një testi të sigu...

BOTA 19 Shtator14:25

**Kërcënimi rus në Baltik/ Presidenti Stubb u kërkon finlandezëve të përgatiten për dronët dhe luftën hibride: Moska po godet Evropën**

Presidenti i Finlandës, Alexander Stubb, u ka bërë thirrje qytetarëve të tij të jenë të përgatitur për p&eum...

BOTA 19 Shtator14:04

**Dy dronë të paidentifikuar shkelin hapësirën ajrore të Moldavisë, alarm në Kishinau**

Policia Kufitare e Moldavisë njoftoi të shtunën se patrullat kishin raportuar disa dronë të paidentifikuar që fluturuan në ...

BOTA 19 Shtator13:50

**Musk, Bezos e Altman në Shtëpinë e Bardhë/ Miliarderët e teknologjisë, të ftuar në darkën për Xi Jinping**

Disa prej emrave më të fuqishëm të teknologjisë amerikane do të jenë të pranishëm javën e ardhshme n&e...

BOTA 19 Shtator13:18

**Aneksim jo, mbrojtje me ushtri, çfarë parashikon marrëveshja SHBA-Danimarkë për Groenlandën**

Fjala aneksim u hoq nga ‘përdorimi’. Shtetet e Bashkuara dhe Danimarka kanë arritur një marrëveshje për sigurinë e G...

BOTA 19 Shtator11:53

**Shqipëria i bashkohet NASA-s për eksplorimin e Hënës dhe Marsit, nënshkruan Marrëveshjet Artemis**

Shqipëria do të bëhet vendi i 73-të nënshkrues i Marrëveshjeve Artemis, një nismë ndërkombëtare e udhëh...

BOTA 19 Shtator11:25

**Pak javë para votimit në Izrael, sondazhi nxjerr Eisenkot përpara Netanyahut**

Një sondazh i publikuar në Izrael pak javë para zgjedhjeve parlamentare të 27 tetorit tregon se kryeministri Benjamin Netanyahu mbetet pas...

BOTA 19 Shtator10:40

**Meta përgatit syzet inteligjente pa kamera/ “Luna” mund të prezantohet së shpejti**

Meta po përgatit një palë të reja syzesh inteligjente, të cilat pritet të dallohen nga modelet aktuale të kompanisë p&...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 18 Shtator

[VIDEO dramatike/ Të dashurës i erdhi burri, i r...]

Ky është momenti kur një burrë, gjysmë i zhveshur, u rrëzua nga një dritare teksa tentonte të arratisej, pasi dyshohet s...

AKTUALITET 19 Shtator

[Të shtëna me armë në një kantier ndërtimi në Ti...]

Të shtëna me armë zjarri janë regjistruar në orët e para të mëngjesit në një kantier ndërtimi në T...

AKTUALITET 19 Shtator

[Dy turiste suedeze në Tiranë: Ftuam në shtëpi 3...]

Dy turiste nga Suedia, që kishin mbërritur në Tiranë në 4 shtator 2026, pretendojnë se janë abuzuar seksualisht nga 5 djem, t...

INVESTIGIME 19 Shtator14:14

[Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës]

Në shumë raste, ndarja e një çifti me fëmijë të mitur shoqërohet me konflikte, përplasje e drama që godasi...

## video



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**




**“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit**






Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.